



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 241/B prot.

Tiranë, më 27.07.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 2141/1, DATË 17.07.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË PRAKTIKËS SË PËRCJELLË NGA ISH KLD, PËR ANKESËN E SHTETASES ZNJ. NERTILA DEDEJ DHE EMISIONIT "FIKS FARE", LIDHUR ME FAKTIN E MOSZBARDHJES SË VENDIMEVE TË PERIUdhËS JANAR-PRILL 2018, NGA ANA E GJYQTARËVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DURRËS"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e znj. Nertila Dedej dhe Emisionit "Fiks Fare" me nr. 917 prot., datë 16.02.2021, ndaj veprimtarisë gjyqësore të ish magjistratit z. E.G., gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe me vendimin nr. 2141/1, datë 17.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të praktikës së përcjellë nga ish KLD, për ankesën e shtetases znj. Nertila Dedej dhe Emisionit "Fiks Fare", lidhur me faktin e moszbardhjes së vendimeve të periudhës janar-prill 2018, nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës", bazuar në nenet 120, pika 1, shkronja b), 121 pika 2, shkronja a) të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Rrogozhinë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rrogozhinë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

